

VENDIM
Nr.566, datë 28.5.2009

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE USHTARAKE TË HUAJA NË STËRVITJEN E
PËRBASHKËT “ADRION LIVEX-09”, NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 14 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen e 200 (dyqind) forcave ushtarake të huaja në stërvitjen e përbashkët, të koduar “ADRION LIVEX-09”, që do të zhvillohet në hapësirën detare të Republikës së Shqipërisë dhe ujërat ndërkombëtare, nga data 7 deri 12 qershor 2009.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi, duke bërë publikimin e zonës detare, ku do të zhvillohet stërvitja, nëpërmjet njoftimit të organeve kompetente, që veprojnë në Portin e Durrësit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha